



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Urbanizmit
Periodha raportuese	Dhjetor 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Lydra Hoxha

1. PËRMBLEDHJE


Në Sektorin e urbanizmit, gjatë këtij muaji janë pranuar 122 (njëqind e njëzet e dy) kërkesa të ndryshme, prej të cilave 14 (katërbëdhjetë) kërkesa për leje ndërtimi. Janë caktuar kushte ndërtimore për 7 (shtatë) ndërtesa, janë lëshuar 9 (nëntë) leje ndërtimi, ku 5 (pesë) prej tyre për ndërtesa të kategorisë II, ndërsa të tjerat 4 (katër), të kategorisë I, janë lëshuar 11 (njëmbëdhjetë) vendime - pëlqime të ndryshme, janë refuzuar 9 (nëntë) kërkesa, si dhe janë dhënë shumë informime për plotësim dokumentacioni, aktvendime kompensime e të ngjashme.

Është lëshuar 1 (një) leje ndërtimi për infrastrukturë.

Të dhëna statistikore për Sektorin e urbanizmit:

Lëndët e pranuarat	Kushte ndërtimore	Leje ndërtimore	Konstatime për refuzim	Vendime-Pëlqime
122	7	9	9	11

Krahasimi mes muajve janar- dhjetor 2016



Vazhdon regjistrimi i lëndëve në Sistem të vrojtimit të lëndëve.

Ende nuk është duke proceduar me kërkesat për ndërtesat e papërfunduara, të identifikuar nga procesi i legalizimit, për shkak të mangësive ligjore dhe pritjet plotësim-ndryshimi i Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Janë realizuar shumë takime me qytetarë për konsulta para aplikimit për leje ndërtimore ose kushte ndërtimore, sidomos për objektet e kategorisë II, ku u janë dhënë sqarimet dhe janë udhëzuar për procedura të mëtutjeshme. Janë realizuar edhe takime të kolegjiut me zyrtarë për gjetjen e zgjidhjeve për lëndët më të komplikuara.

Në sektorin e legalizimit kanë vazhduar me plotësime dokumentacioni për lëndët e aplikuara për legalizim, 19 (nëntëmbëdhjetë) ndërtime janë legalizuar, ndërkohë që për 80 (tetëdhjetë) ndërtime të tjera pritet të kryhet pagesa e taksës për legalizim, si dhe për lëndët tjera nevojitet të dorëzohet plotësimi i dokumentacionit për të vazhduar më tutje me procedura të legalizimit.

Në zyrën për regjenerim urban janë zhvilluar vizita të vazhdueshme për mbikëqyrjen e punimeve në QMF-në Studentore, gjithashtu është vazhduar me punët lidhur me ridizajnimin e shkallëve në rrugën “Dëshmoret e Kombit”, rastet e nevojshme për ndërhyrje në bashkëpunim në bizneset.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Zbatimi i bazës ligjore për planifikim e ndërtim - shqyrtimi i lëndëve duke respektuar afatet ligjore;
- Vlerësimi i lëndëve nga Grupi profesional – Kolegjiut, si dhe marrja e vendimeve për lëndët ku ka dilema në zgjidhje;
- Takimet me qytetarë të interesuar për zgjidhjet urbane deri në arritjen e zgjidhjes dhe përgatitjet para aplikimit për kushte ndërtimore;
- Digjitalizimi i plotë i arkivit për qasje dhe përpunim sa më të lehtë, si dhe sistemimi i kopjeve fizike të arkivit.
- Përpunimi i sistemit “Permit Tracking System”, që të jetë sa më thjesht i përdorshëm për zyrtarët dhe i lexueshëm për qytetarët.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

- Përfundimi i lëndëve me dokumente konkrete;
- Publikimi i lejeve ndërtimore në ueb-faqen e Komunës;
- Takimet e rregullta të zyrtarëve shqyrtues me grupin profesional - kolegjiutin për lëndë konkrete;
- Takime të shumta me qytetarë për konsultim rreth zgjidhjeve urbane, të propozuara, para aplikimit për kushte ndërtimore;
- Përgjigje në kërkesa të ndryshme sa i përket punës së sektorit;
- Takim i grupit/ kolegjiut lidhur me diskutimin rreth plotësimit dhe ndryshimit të UA 10/2013, 09/2013, 18/2013, 21/2013, të MMPH-së;
- Takimet e shumta me zyrtarët e Sektorit ligjor të Komunës;
- Takimet me zyrtarët e Drejtorisë së Kadastrit;
- Takime me zyrtarët e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave;

- Ka filluar zbatimin e sistemit të aplikimit “online” për qasje në dokumente zyrtare;
- Dekorimi i shesheve të qytetit për festat e fundvitit.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

- Vazhdohet me zbatimin e bazës ligjore, duke u përpjekur që të respektohen afatet ligjore;
- Vazhdon puna në sistemin e informimit për monitorimin e procedurës së marrjes së lejes së ndërtimit nga qytetarët, si masë e transparencës;
- Vazhdon puna në zgjidhje urbane të ndryshme, deri në miratimin e tyre;
- Vazhdon publikimi i të gjitha lejeve të lëshuara ndërtimore nga Sektori i urbanizmit, duke punuar me kronologji nga lejet më të fundit;
- Janë definuar standardet dhe procedura e fillimit të futjes së të dhënave në sistemin GIS, përkatësisht të situacioneve të zgjidhjeve urbane, të miratuara me kushte ndërtimore, vendosja e gabariteve të objekteve të planifikuara, për të cilat është dhënë leja ndërtimore, si dhe sistemi i adresave;
- Vazhdimisht janë duke u identifikuar pengesat në zbatim të planeve;
- QMF Studentore;
- Shkallët në rr. “Dëshmoret e Kombit”.

4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

4.1.3 Takimet me palë

Kanë vazhduar takimet me palë të martave dhe të enjteve, me përjashtime edhe ditëve të tjera, sipas nevojës.

5. TAKIMET ME INSTITUCIONET TJERA

Gjate muajit dhjetor, janë mbajtur takime me institucione qendrore, si :

- Takimi me inspektorë të ndërtimit të MMPH-së;
- Takim me zyrtarët e MMPH-së, Departamenti i Planifikimit;
- Takimi me përfaqësues të USAID-it dhe MMPH-së;
- Takim me zyrtarë të Agjencisë për Menaxhim Emergjent;
- Takimi me UN - Habitat, konsulta të nevojshme për problemet e hasura në zbatimin e projektit “Bllok pas Blloku”;
- Takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e “Deloitte” për projektet e PPP-së.

6. DISKUTIME PUBLIKE/TAKIMET ME QYTETARË

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare - 6

6.1.2. Lëndët e pranuar dhe të kryera - 239

Në tabelë gjeni të dhënat nga Sektori i urbanizmit lidhur me kërkesat e pranuar, të përfunduara dhe në procedurë, për muajin dhjetor 2016:

Lëndët e pranuar	Të kryera
122	117

Në numrin e përgjithshëm prej 122 lëndëve të kryera, llogariten edhe caktimi i pikave, konkluzionet, informimet e ndryshme të tjera të formës së prerë, derisa janë kryer edhe shumë aktivitete në proces të përcaktimit të kushteve ndërtimore, si dhe dhënies së lejeve të ndërtimit, që nuk mund të konsiderohen si kryerje e lëndës, por aktivitete që ndikojnë në kryerje të lëndëve.

7. TAKIME TË TJERA

Gjatë këtij muaji, Sektori i urbanizmit ka realizuar takim edhe me KEDS-in, në bashkëpunim me zyrtarë të MMPH-së dhe USAID-it për shqyrtimin e procedurës së marrjes së pëlqimeve nga KEDS-i.

8. SFIDAT

Sfidë për Sektorin mbetet edhe më tutje çështja e trajtimit të lëndëve nga legalizimi për objektet e papërfunduara, të regjistruara në regjistrin e ndërtimeve pa leje, deri në miratimin e ligjit të ri.

9. REKOMANDIME

- Të mundësohen trajnime ose vizita zyrtare të stafit sa i përket procedurës për pajisje me leje ndërtimore;
- Të furnizohet Drejtoria me pajisje për sistemim të dosjeve fizike të Arkivit me pajisje për skenim të lëndëve, aparat fotokopjues etj.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

- Vazhdimi me shqyrtimin e lëndëve (miratim, refuzim);
- Procedimi i lëndëve, sipas afatit kohor të paraparë me ligj;
- Analizat dhe listimi i aktiviteteve të nevojshme përgatitore për sistemin “online” për pajisje me leje ndërtimore;
- Konsultime me palë në lidhje me projektet- në formë të shtypur në fleta A3 (para fazës së aplikimit për leje);
- Vazhdimi i plotësimit me informata të programit “Permit Tracking System” dhe organizimi i azhurnimit të të dhënave dhe publikimi i lejeve të lëshuara në ueb-faqe;

- Aktiviteti rreth avancimit të shërbimit të informimit të qytetarëve për procedurat e Urbanizmit;
- Vazhdimi i publikimit të Lejeve të ndërtimit në ueb-faqe të Komunës;
- Miratimi dhe publikimi i taksës së ndërtimit, si dhe tarifat përkatëse;

11. TË TJERA